



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

LICENCË PËR OPERATORIN E TREGUT TË ENERGJISË

DHËNË :

**OPERATORIT TË SISTEMIT TË
TRANSMISIONIT DHE TREGUT SH.A**

Numri i Regjistrimit: ZRRE/Li_16/12



PËRMBAJTJA

KREU I: TERMAT E LICENCËS.....	3
KREU II: KUSHTET E LICENCËS	4
Neni 1: Përkufizimet.....	4
Neni 2: Autorizimi i Dhënë Sipas Kësaj Licence.....	4
Neni 3: Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Operatorit të Tregut.....	5
Neni 4: Pavarësia Ligjore dhe Menaxheriale.....	6
Neni 5: Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve	6
Neni 6: Ndalimi i Diskriminimit	6
Neni 7: Rregullat e Tregut	6
Neni 8: Aderimi në Rregullat e Tregut	7
Neni 9: Komunikimet Operacionale	7
Neni 10: Kufizimet në Përdorimin e Informatës së Caktuar	8
Neni 11: Puna	8
Neni 12: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit	9
Neni 13: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së	9
Neni 14: Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës.....	9
Neni 15: Masat Administrative dhe Gjobat	10
Neni 16: Zgjidhja e Kontesteve.....	10



KREU I: TERMAT E LICENCËS

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji** (tani e tutje "ZRRE "), në pajtim me autoritetit e dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185), Nenin 15 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 03/L-184), Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L-201) dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, **i modifikon KOSTT-OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT DHE TREGUT SH.A.** (tani e tutje "i Licencuari"), **Licencën për Operatorin e Tregut**, për menaxhimin ekonomik të sistemit të energjisë elektrike.
2. Territori i mbuluar nga kjo licencë është i tërë territori i Republikës së Kosovës.
3. I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me Nenet e përcaktuara në këtë licencë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
4. I Licencuari do të veprojë si në vijim:
 - 4.1. kryej në mënyrë efikase obligimet e përcaktuara me këtë licencë;
 - 4.2. nxisë konkurrencën efektive për prodhim dhe furnizim me energji elektrike; dhe
 - 4.3. nxisë efikasitetin ekonomik në zbatimin e Rregullave të Tregut.
5. Licenca vlen nga data **4 Tetor 2006** dhe do të jetë vazhdojë të jetë e vlefshme për një periudhë tridhjetë (30) vjeçare, deri më **4 Tetor 2036**, me mundësi vazhdimi në pajtim me Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
6. Në pajtim me Nenin 34 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë modifikon licencën për operator tregu me numër licence ZRRE/Li_16/06 e lëshuar me datë 04 tetor 2006 nga Zyra e Rregullatorit për Energji, dhe hynë në fuqi me datë **18.07.2012.**

E vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë: _____.

Nënshkruar (në emër të Bordit të ZRRE-së): _____



KREU II: KUSHTET E LICENCËS

Neni 1: Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptimin si në vijim:

“Marrëveshja për aderim” - dokumenti i nënshkruar nga të gjitha palët të cilat bien dakord të veprojnë sipas Rregullave të Tregut siç përcaktohet në Rregullat e Tregut;

“Anëtar” - marrëdhënie e drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo ndërmarrje Aksionare apo Vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës i ndonjë ndërmarrje Aksionare të të Licencuarit, e themeluar sipas legjislacionit në fuqi.

“Vit financiar” - periudha prej 1 Janar deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

“Njësi gjeneruese” - çdo central apo pajisje për gjenerimin e energjisë elektrike siç përcaktohet me Kodin e Rrjetit.

“Kompani Aksionare” - çdo kompani e definuar si e tillë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

“Legjislacion” – Ligji për Energjinë (Ligji Nr. 03/L - 184), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L - 185), Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L - 201) si dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë.

“Rregulla të Tregut” - rregulla të miratuara nga ZRRE që përcaktojnë funksionimin e tregut të energjisë elektrike dhe raportet në mes të Operatorit të Tregut, si dhe bashkëveprimet midis këtyre palëve dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit.

“Vartës” - çdo ndërmarrje në pronësi apo e kontrolluar nga një kompani tjetër, e që definohet sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.

2. Termet tjera të përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptimin si termet e përdorura në Legjislacionin në fuqi dhe Rregullat e Tregut të aprovuara nga ZRRE.

Neni 2: Autorizimi i Dhënë Sipas Kësaj Licence

1. I Licencuari në përputhje me Rregullat e Tregut, është i autorizuar që të kryej aktivitetet si në vijim:

- 1.1. aderojë në Rregullat e Tregut në cilësinë e “pronarit”;
- 1.2. mbajë proces për aderim në Rregullat e Tregut për të gjitha Palët Tregtare;
- 1.3. administrojë tregun e centralizuar të energjisë elektrike;
- 1.4. menaxhojë procesin e transferit të konsumatorit;



- 1.5. mirëmbajë llogaritë për Operatorin e Tregut, Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe të Palëve Tregtare;
 - 1.6. menaxhojë procesin e barazimit përfundimtarë;
 - 1.7. faturojë obligimet reciproke financiare të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut dhe Palëve Tregtare;
 - 1.8. veprojë si agjent për barazim financiar për Operatorin e Sistemit të Transmisionit;
 - 1.9. sigurojë informacione mbi tregun e energjisë elektrike; dhe
 - 1.10. ushtrojë funksione tjera që i janë caktuar me Rregullat e Tregut.
2. I Licencuari nuk do të caktojë dhe/ose transferojë, dhe as nuk do të ketë për qëllim të caktojë ose transferojë ndonjë nga të drejtat ose detyrimet e veta që i janë dhënë me anë të kësaj licence pa aprovimin paraprak të ZRRE-së.

Neni 3: Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Operatorit të Tregut

1. I Licencuari do të përgatisë Pasqyrat Financiare vjetore, duke përjashtuar aktivitetet e Operatorit të Sistemit, në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, të nxjerrë nga ZRRE-ja, dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së një kopje të Pasqyrave Financiare të audituara brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit financiar.
2. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara nga auditori i pavarur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar.
3. I licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin për aktivitetin e Transmisionit në tërësi, si dhe për aktivitetet tjera. Kontabiliteti rregullativ do të jetë në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet, i cili ndër të tjera mund të specifikojë:
 - 3.1. formën e regjistrave/pasqyrave rregullative të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në llogaritë e fitimit dhe humbjes (bilanci i suksesit), bilancin e gjendjes, fitimet e njohura dhe pasqyrat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme (cash-flow) dhe deklaratat për shumatat e të ardhurave, shpenzimeve, asetëve, detyrimeve, rezervave ose kushteve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë aktivitet tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis aktivitetit të konsoliduar të operimit të tregut dhe ndonjë aktiviteti tjetër;
 - 3.2. natyrën dhe përmbajtjen e regjistrave/pasqyrave rregullative të kontabilitetit, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, asetëve ose borxheve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe detyrimet nga aktivitetet e specifikuara; dhe
 - 3.3. parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
4. Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshojë bazat e tarifimit, shpërndarjes ose alokimit që janë



përdorur në vitin financiar paraprak, përveçse nëse ZRRE-ja nxjerr më parë udhëzimin relevant ose jep aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.

5. I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me çdo udhëzim të nxjerrë nga ZRRE-ja dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 4: Pavarësia Ligjore dhe Menaxheriale

1. I Licencuari nuk ka të drejtë të jetë i angazhuar në prodhim të energjisë elektrike, furnizim publik dhe ose furnizim të energjisë elektrike.
2. I Licencuari duhet të veprojë si në vijim:
 - 2.1. personat që janë përgjegjës për menaxhimin e të Licencuarit, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në strukturat e ndonjë kompanie që posedon licencë për prodhim, shpërndarje ose furnizimit të energjisë elektrike në Kosovë;
 - 2.2. i Licencuari do të marrë masat e duhura për të siguruar që të merren parasysh interesat profesionale të personit përgjegjës për menaxhimin e të Licencuarit, në mënyrën që siguron se ata janë të aftë për të vepruar në mënyrë të pavarur;
3. I Licencuari do të zbatojë Kodin e Sjelljes ku përcaktohen masat që janë të nevojshme për të siguruar përjashtimin e sjelljeve diskriminuese dhe monitorimin e duhur të respektimit të këtyre masave.
4. I licencuari do të publikojë në faqen e tij elektronike zyrtare Kodin e Sjelljes.

Neni 5: Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve

I Licencuari do të parandalojë apo evitojë që aktiviteti i Operatorit të Tregut të japë apo të marrë ndonjë subvencion apo ndër-subvencion (direkt apo të tërthortë) prej ndonjë aktiviteti tjetër të të Licencuarit dhe/ose ndonjë Vartësi (ortaku) apo anëtarit dhe ose ndonjë personi tjetër.

Neni 6: Ndalimi i Diskriminimit

1. I Licencuari nuk do të bëjë diskriminime midis Palëve Tregtare, ose çdo personi që dëshiron të bëhet Palë Tregtare, dhe do të kryejë funksionet e veta, duke respektuar parimet e transparencës, objektivitetit dhe pavarësisë.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni Pala Tregtare mund të trajtohet ndryshe nga i Licencuari sipas rrethanave të specifikuara dhe të lejuara me Rregullat e Tregut.

Neni 7: Rregullat e Tregut

1. I Licencuari do të veprojë në pajtim me Rregullat e Tregut në fuqi.



2. Rregullat e Tregut të nxjerra në përputhje me Legjislacionin në fuqi dhe këtë Licencë, nuk mund të ndryshohen pa aprovimin me shkrim të ZRRE-së.
3. I Licencuari do të jetë përgjegjës për menaxhimin e çdo modifikimi të Rregullave të Tregut, sipas dispozitave përkatëse të Rregullave të Tregut, si dhe të dërgojë çdo propozim për modifikim në ZRRE për miratim pas konsultimit adekuat me palët që do të ndikohen nga ky modifikim. Kur ZRRE e udhëzon, i Licencuari do të ndërmerr veprimet për modifikimin e Rregullave të Tregut e në përputhje me udhëzimet e ZRRE-së.
4. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e disa dispozitave të Rregullave të Tregut. ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës nga i licencuari mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.

Neni 8: Aderimi në Rregullat e Tregut

1. I Licencuari do të hyjë në Marrëveshje për Aderim me të gjithë personat që dëshirojnë të nënshkruajnë një marrëveshje të tillë dhe të bëhen Palë në Rregullat e Tregut, dhe të cilët janë të Licencuar për aktivitetet që ata dëshirojnë të ndërmarrin. I Licencuari do të njoftoj ZRRE-në për të gjitha kërkesat e pranuar nga personat që dëshirojnë të hyjnë në Marrëveshje për Aderim, në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut.
2. I Licencuari është i detyruar të monitorojë përputhshmërinë e Palëve Tregtare sipas Marrëveshjeve për Aderim, dhe në përputhje me Rregullat e Tregut.
3. I Licencuari mund ti përfundojë këto Marrëveshje për Aderim në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut.
4. I Licencuari do t'u vendosë Palëve pjesëmarrëse në Treg detyrime të aplikueshme (Detyrimet e Operatorit të Tregut), si dhe ndonjë shumë të nevojshme për të siguruar tregun, ashtu siç përcaktohet në Rregullat e Tregut.

Neni 9: Komunikimet Operacionale

1. I Licencuari, për qëllim të menaxhimit të barazimeve përfundimtare do të sigurojë kompjuterë, pajisjet tjera të përshtatshme, softuerë, si dhe do të hartojë dhe publikojë standardet e nevojshme për komunikimin me këtë softuer, duke përdorur standardet ndërkombëtare, e në përputhje me Rregullat e Tregut.
2. I Licencuari do të sigurojë që Softueri për barazimet përfundimtare të kontrollohet nga kompania e duhur, e pavarur dhe e kualifikuar për auditim, për të përcaktuar përputhshmërinë me Rregullat e Tregut.
3. I Licencuari do të mirëmbajë shënime të plota dhe të sakta për të gjitha të dhënat për barazimet përfundimtare që janë paraqitur nga Palët Tregtare ose që janë mirëmbajtur



nga i Licencuari. Formati për ruajtjen e këtyre shënimeve do të përcaktohet nga i Licencuari.

Për qëllimet e këtij Neni:

“Të Dhënat e barazimit përfundimtar” - jenë të gjitha të dhënat që sipas Rregullave të Tregut nevojiten të furnizohen nga i Licencuari ose nga Palët Tregtare që mundësojnë kryerjen e barazimit përfundimtar sipas Rregullave të Tregut.

Neni 10: Kufizimet në Përdorimin e Informatës së Caktuar

1. I Licencuari nuk duhet të zbulojë informacionet konfidenciale ndaj ndonjë aktiviteti tjetër të të Licencuarit ose ndonjë Vartësi apo ndërmarrjeje tjetër të tij, në mënyrë direkte ose indirekte, përveç në rast se Rregullat e Tregut parashikojnë publikimin e informacioneve të tilla.
2. I Licencuari, aty ku është e nevojshme për të kryer aktivitetin e tij të licencuar, mund të zbulojë çdo informacion përveç atij konfidencial të mbajtur dhe/ose fituar gjatë kryerjes së funksioneve të veta si Operator i Tregut. Pavarësisht nga kjo, i Licencuari do t'i zbulojë informatat, duke përfshirë edhe ato konfidenciale:
 - 2.1. Nëse ato informata i kërkon ZRRE-ja për të kryer obligime që i janë dhënë me Legjislacionin në fuqi; apo
 - 2.2. Nëse ato informata i kërkojnë Operatori i Sistemit të Transmisionit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes apo ndonjë Operator tjetër i Sistemit apo Tregut, dhe që zbulimi i tyre është i domosdoshëm për përmbushjen e obligimeve të të Licencuarit të përcaktuara me Legjislacion apo këtë Licencë.
3. I Licencuari do të sigurojë që çdo dokument që përmban informacione konfidenciale (të fshehta), duhet ta bëjë identifikimin e qartë të informacionit si konfidencial (ta shënjojë si informatë konfidenciale).
4. I Licencuari do të marrë masat e parapara për të parandaluar zbulimin e informacioneve konfidenciale nga çdo person dhe këto informata nuk mund të përdoren apo zbulohen për ndonjë qëllim tjetër nga ajo që është dhënë sipas dispozitave përkatëse të ligjeve në fuqi.
5. Për qëllimet e këtij Neni “Informata konfidenciale” do ta ketë kuptimin e njëjtë të përcaktuar në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 11: Puna

I Licencuari lidhur me marrëdhënien në punë dhe sigurinë në punë do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.



Neni 12: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit

1. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE-ja nuk e aprovon atë.
2. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim të Strukturës Organizative të të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t'i bëhet ZRRE-së jo më vonë se tre (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.

Neni 13: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së

1. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE informacione dhe raporte në mënyrën dhe në afatet që ZRRE-ja mund t'i konsiderojë të nevojshme.
2. I Licencuari do të dërgojë në ZRRE raporte tremujore dhe vjetore mbi veprimtarinë e Operatorit të Tregut si dhe pajtueshmërinë me kushtet e Licencës sipas Doracakut të Raportimit për Sektorin e Energjisë, të miratuar nga ZRRE-ja.
3. Nëse i Licencuari, në përputhje me Rregullën për Informatat Konfidenciale, kërkon që një informacion i caktuar të konsiderohet si konfidencial atëherë është obligim i tij që të shënjojë atë informacion si konfidencial dhe të arsyetojë kërkesën e tij te ZRRE-ja. ZRRE do të shqyrtojë kërkesën e tillë në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
4. Zyra e Rregullatorit për Energji ka të drejtë të kërkojë nga I licencuari çdo informatë konfidenciale, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me Nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
5. I Licencuari duhet t'i dërgojë ZRRE-së detajet për çdo ndryshim në informata që janë dërguar gjatë aplikimit për këtë licencë.

Në këtë Nen:

"Informacion" – materiali në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.

Neni 14: Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës

1. ZRRE-ja mund të vazhdojë, modifikojë, pezullojë, dhe ndërpresë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.



2. ZRRE-ja mund të transferojë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, por duke siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen për shkak të një transferimi të tillë.

Neni 15: Masat Administrative dhe Gjobat

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfshirë Rregullat e nxjerra nga ZRRE, Nenet e kësaj Licence apo instruksionet dhënë të Licencuarit nga ana e ZRRE-së, ZRRE-ja ka kompetenca t'i vendos të licencuarit masa administrative dhe gjoba, në përputhje me Nenin 52 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.
3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

Neni 16: Zgjidhja e Kontesteve

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet në përputhje me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE-ja.
2. Vendimet e ZRRE-së lidhur me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të kontestohen nga i Licencuari në gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.